Бр./Nr_______

_________г./v.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 95-të të mbajtur më 15.11.2023, ka miratuar sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-9110/1 nga 01.11.2022, me pretendime për ndërtim të paligjshëm për ushtrimin e ndikimit dhe shkaktimin e dëmit në pronë, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-9110/1 nga 01.11.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 01.11.2022, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendimin për ndërtim pa leje, ushtrim ndikimi dhe dëmtim pronësor dhe është konstatuar rasti me numër 12-9110/1, datë 01.11.2022.

Në denoncim, parashtruesi, pa treguar qartë ngjarje konkrete dhe pa treguar veprime konkrete të kundërligjshme, paraqet pretendime për dëmtim të pronës personale nga i afërmi i tij, i cili dyshohet se është ndihmuar nga një i njohur i tij - person i punësuar në Komunë///. Për më tepër, denoncimi përmban pretendime për ndërtime të paligjshme në tokë shtetërore në territorin e Komunës/// dhe mos marrjen e masave nga kryetari i komunës dhe inspektori i autorizuar ndërtimor për parandalimin e saj.

Në shtojcë të denoncimit, parashtruesi dorëzoi një kopje të shkresës inspektorit të autorizuar të ndërtimit pranë Komunës/// dhe një kopje të procesverbalit të inspektimit të kryer.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se në rastin parashtruesi i denoncimit tashmë i ishte drejtuar një autoriteti kompetent - një inspektor i

autorizuar ndërtimi pranë Departamentit për Mbikëqyrjen Inspektuese të Komunës /// i cili ka vepruar dhe ka kryer një inspektim , KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Dorëzuar:
- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M.
Miratoi: Mr. V.G, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Nënkryetar**
**Sofka Pejovska Dojçinovska**

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk